

VENDIM
Nr. 484, datë 8.6.2013

PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT QENDROR TË
ZGJEDHJEVE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, QË DO
TË ZHVILLOHEN MË 23.6.2013

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e memorandumit të bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, që do të zhvillohen më 23.6.2013, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministri i Brendshëm, që, në emër të Këshillit të Ministrave, të nënshkruajë këtë memorandum, si dhe të ndjekë zbatimin e të drejtave dhe të detyrimeve që përcaktohen në të.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha